REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo
Ministria e Financave / Ministarstvo za Financije
Ministry of Finance
Administrata Tatimore e Kosovës / Poreska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosova
Departamenti i Ankesave
Nr. Prot. 444/2022 Data 01.11.2022
PRISHTINË

ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS- Divizioni i Ankesave (DA-ve) në përbërje te panelit shqyrtues: Ramadan Ahmeti kryesues, Flora Veliu dhe Emine Nikqi anëtare paneli, duke vendosur në çështjen administrative tatimore sipas ankesës së subjektit [redacted] me numër të regjistrimit të biznesit (NUI): [redacted] me pronar [redacted], me seli të biznesit në Rr. "Adem Jashari"-Hani i Elezit , e dorëzuar në Administratën Tatimore-Divizionin e Ankesave më datë 13.10.2022 protokolluar me nr.444/2022, kundër Vendimit ILP. Nr. R-026/2022 të lëshuar nga ATK-Komisionit për Lirim nga Tatimi në Vlerën e Shtuar në Import të Lëndës së Parë , në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr. 03/L-222 mbi "Administratën Tatimore dhe Procedurat", mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet e pa bazuar ankesa me Nr. 444/2022 e datës 13.10.2022 e subjektit në procedurë, "[redacted] Sh.p.k. me numër të regjistrimit të biznesit (NUI) [redacted] me pronar [redacted], me seli të biznesit në Rr. "Adem Jashari"-Hani i Elezit, në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 "Për Procedurën e Përgjithshme Administrative" në lidhje me paragrafin 2 të nenit 89 të Ligjit nr. 03/L-222," Për Administratën Tatimore dhe Procedurat".

II. Vendimi me Nr. ILP TVSH: NR:R-026/2022 datë 02.08.2022 lëshuar nga ATK-Komisionit për Lirim nga Tatimi në Vlerën e Shtuar në Import të Lëndës së Parë, vërtetohet si i bazuar.

A r s y e t i m

Tatimpaguesi më datë 11.10.2022 ka pranuar vendimin ILP TVSH Nr. R-026/2022 të Lëshuar nga Komisioni për Lirim nga TVSH-ë në import Zyra Qendrore e ATK-së dhe brenda afatit të përcaktuar ligjor, ka parashtruar ankesë më datë 13.10.2022 në Administratën Tatimore të Kosovës-Divizionin e Ankesave, në përputhje me nenin 77, paragrafin 2, të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, si dhe nenin 44, paragrafin 7, të Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2010 për Zbatim të Ligjit Nr. 03/L-222 mbi "Administratën Tatimore dhe Procedurat".

Vendimi nr. ILP TVSH:NR: R-026/2022 datë 02.08.2022- Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të tatimpagueseve për lirimin nga TVSH-ja nga Importet e lëndës së parë - n këtë raste linjit-qymyr, pas shqyrtimit të kërkesës së tatimpaguesit për lirim në importet për lëndën e parë-linjit, ka refuzuar kërkesë si të pa bazuar me arsyetim se nuk është bërë kompletimi i dokumentacionit për ta liruar në import në mbështetje të nenit 29 të Ligjit nr.05/L-037 për TVSH-ë dhe nenin 48 të UA nr.03/2015, dhe vendimeve nga Qeveria e Kosovës nr.13/07 të datë 06.10.2017 dhe vendimi nr.14/07 datë 06.10.2017.

Ankesë me shkrim-Tatimpaguesi i pa kënaqur me vendimin e lëshuar nga ATK-Komisioni për Lirim nga Importet në TVSH-ë , ka parashtruar ankesë me arsyetim, se : ne këtë produkte me kod tarifor 27021000 e shfrytëzojmë si lëndë e parë për prodhimin e bllokave "Siporex" dhe nuk e shfrytëzojmë si produkt të gatshëm , ne po ashtu edhe më herët me vendimet e lëshuara nga ATK ILP TVSH jemi liruara edhe për produktet të cilat i importojmë si lëndë e parë.
Andaj, ne si kompani prodhuese kërkojmë nga ju që ta rishqyrtoni edhe një herë këtë vendim pasi që për ne është shumë i rëndësishëm sepse pothuaj se mbi70% të prodhimit e eksportojmë në vendet e rajonit.
Ankesës tatimpaguesi i ka bashkangjitur : vendimin nr. ILP TVSH NR.R-026/2022 ; Kërkesën për lirim nga TVSH-ja ; Normativi i prodhimit dhe Vendimet për lirim nga TVSH-ja –Dogana dhe akciza nr.142/2020.

Administrata Tatimore e Kosovës-Divizioni i Ankesave pas shqyrtimit dhe pretendimeve në ankesës, administrimit dhe vlerësimit të gjitha provave në shkresat e lëndës dhe provave të ofruara nga tatimpaguesi , paneli shqyrtues me datë 28.10.2022 vlerësoi se ankesa e subjektit në procedurë është e pa bazuar.

Dispozitivi i këtij Vendimi të Divizionit të Ankesave është i mbështetur në faktet në vijim:
Divizioni i Ankesave pas shqyrtimit të vendimit nr. ILP TVSH:R-026/2022 datë 02.08.2022 mbi refuzimin e kërkesës për lirim nga TVSH-ja në importimin e lëndës së parë të lëshuar nga Administratat Tatimore e Kosovës-Komisioni i themeluar nga Drejtori i Përgjithshëm , pas verifikimit të provave materiale në shkresat e lëndës, ballafaqimit të fakteve dhe analizimit me bazën ligjore, nenin 29, paragrafin 1.12, të Ligjit nr.05/L-037 , për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar , dhe nenin 48 të UA nr.03/2015, konstaton se ankesa e tatimpaguesit është e pa bazuar, dhe mbetet në fuqi Vendimi i Komisionit për shqyrtimin e kërkesave për lirim të TVSH-së në importimin e lëndës së parë.
DA, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe vlerësimit të ligjshmërisë, ka administruar provat relevante në shkresat e lëndës dhe atë : vendimin e ATK-së nr. ILP TVSH:NR:R-026/2022 datë 02.08.2022; normativat e prodhimit vendimin nnr.142/2020 lëshuar nga ATK-ë , Komisioni i shqyrtimit të kërkesave të tatimpaguesve për lirim nga TVSH-ja në importimin e lëndës së parë për çështje të prodhimit; anekset e vendimit datë 10.03.2022; përshkrimi tabelare i numrit tarifor /doganor dhe i mallrave në importim për lirim nga TVSH-ja si "lëndë e parë" sipas këtij aplikacioni; ILP-Aneks 2, plotësohet për qëllime doganore dhe produkteve që kanë akcizë dhe që lirohen sipas vendimeve të Qeverisë nr.13/07 datë 06.10.2017 dhe 14/07 datë 06.10.20217; formulari i aplikacionit për "lirimet në importim me rastin e importimit të lëndës së parë" , provat e ofruara nga tatimpaguesi me ankesë dhe pretendimet ankimore , nga të njëjtat nxjerr konstatimin se: tatimpaguesi në fjalë ka kërkuar me datë 12.07.2022 për mes formularit zyrtar të aplikacionit për lirim në importim me rastin e importimit të lëndës së parë mbi bazën e dispozitave ligjore, nenin 29 të Ligjit mbi TVSH-ë, dhe nenin 48 të UA nr.03/2015 për zbatim të Ligjit mbi TVSH-në. Komisioni pasi ak shqyrtuar rastin bazuar në shkresat e lëndës ka refuzuar kërkesën e tatimpaguesit sipas vendimit nr. ILP TVSH :NR:R-026/2022 datë 02.08.2022 mbi bazën e dispozitave ligjore të përshkruara më lartë, me arsyetim se nuk ka kompletuar të gjithë dokumentacionin.
Tatimpaguesi i pa kanqur me këtë vendim , ka kërkuar nga DA-ja që ta shqyrtoj rastin dhe të marrë vendim meritor, me arsyetim se ne këtë produkt(linjit-qymyr) e shfrytëzojmë si lëndë të parë për prodhimin e bllokave "Siporex" dhe nuk e shfrytëzojmë si produkt të gatshëm pasi që mbi 70% të prodhimit e bëjmë eksporte , andaj kërkojmë nga ATK-së që ta miratojë këtë ankesë dhe të na liroj nga TVSH-ja në import të këtij produkti.

Dispozita që parashohin: neni 29-Lirimet në importim, paragrafi 1.11-"*Lënda e parë që shfrytëzohet për procesin e prodhimit*".
Neni 48-Lirimet në importim , paragrafi 1. "*Sipas nenit 29, paragrafi 1, nën paragrfat 1.11 dhe 1.12 të ligjit , me rastin e importimit lirohen nga TVSH-ja* "; Paragrafi 1.1-"*lënda e parë që shfrytëzohet për procesin e prodhimit*" , dhe paragrafi 1.2- *Pajisjet e teknologjisë së informacionit* , ndërsa paragrafi 2, parasheh: "*Me lëndë të parë "kuptojmë mallrat e blera të cilat do të hyjnë në prodhim dhe do të transferohen në produkte finale*".
Bazuar në dispozitat e sipërshënuara, DA-ja vlerëson se tatimpaguesi nuk akte drejtë në importimin e lëndës së parë pa TVSH-ë, pasi malli-produkti "Linjit-Qymyr" shfrytëzohet vetëm si mall shpenzues e jo mall që hynë në proces të prodhimit dhe ndërron trajtën në produktin final. Pra kemi të bëjmë me një mall shpenzues i cili do të pranohet nga ATK-ë , e jo mall që hynë në prodhim dhe ndërron vetëm trajtën , andaj nuk qëndron pretendimi i tatimpaguesit se komisioni ka marrë vendim në kundërshtim me dispozitat ligjore, pasi dispozitat nuk parashohin mallin-produktin shpenzues për ta liruara nga TVSH-ja me rastin e importimit.
Sa i përket vendimeve të ofruara nga tatimpaguesi si prova se më parë jemi të liruara nga TVSH-ja, DA-ja vlerëson se vendimet janë lidhur me akcize e jo me lirim nga produkti "linjit" i kërkuar i tatimpaguesi.
Andaj, Divizioni i Ankesave vlerëson se pretendimet e tatimpaguesit në ankesë nuk paraqesin argumente të mjaftueshëm dhe esenciale për të ndryshuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës së për lirim nga TVSH-ja në importimin e lëndës së parë , refuzuar nga Komisioni vlerësues pran ATK-së, prandaj në bazë të gjendjes së faktike , shkresave të lëndës, administrimit të provave dhe dispozitave ligjore , Divizioni i Ankesave konstaton se vendimi nr. ILP TVSH:NR:R-026/2022 i datës 02.08.2022 nga ATK-Komisioni Vlerësues në Prishtinë , është i drejtë dhe i bazuara në dispozitat ligjore në fuqi të ATK-së. Në bazë të gjendjes së konstatuar duke pasur parasysh të gjitha provat të cilat gjendën në shkresat e lëndës , e në përputhje me nenin 132, paragrafi 2 , të Ligjit nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative , Divizioni i Ankesave vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.
KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi bazuar në nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-222 "Për Administratën Tatimore dhe Procedurat", tatimpaguesi i pa kënaqur ka të drejtën që brenda afatit tridhjetë (30) ditësh, nga dita e pranimit të Vendimit të Divizionit të Ankesave, ta kundërshtojë këtë vendim në Divizionin Fiskal të Divizionit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË
Nr.444/2022 datë 01.11.2022

Vendimi t'iu dorëzohet:
1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqësi i Divizionit të Ankesave
Skender Krasniqi _____
Kryesuesi i panelit
Ramadan Ahmeti _____